



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 , 17 dhe 40 par. 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 5 të Rregullores për dhënien e dekoratave nga Komuna e Lipjanit 15Nr.011-20396 e datës 29.03.2019 si dhe neneve 9 , 19 par 19.4 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 05. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E Z. HALIL KASTRATIT, QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Z. HALIL KASTRATI, Kryetar i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" shpallet QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË LIPJANIT .

Neni 2

Me rastin e shpalljes Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit pas miratimit të këtij Vendimi, Kryetar i Komunës së Lipjanit, do të ia dorëzojë solemnisht Z. Halil Kastratit dekoratën "QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË LIPJANIT"

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 170-19917

Lipjan, më 29. 05. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

